



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

**KRITERET DHE DOKUMENTAT PËR HARTUES, RISHIKUES TEZE,
KORRIGJUES DHE RIKORRIGJUES TË PROVIMEVE TË AFTËSIVE
PROFESIONALE**

Njoftohen të gjithë të interesuarit për të aplikuar si korrigjues dhe rikorrigjues, për provimet e aftësive profesionale në disiplinat si më poshtë vijon:

1. *“Zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe të biznesit”- 21 Shtator 2024;*
2. *“Zbatimi i modeleve të duhura të organizimit dhe drejtimit, kontrolli i brendshëm i njësive ekonomike të biznesit dhe përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës”- 28 Shtator 2024;*
3. *“Procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit”- 05 Tetor 2024;*

Kriteret që duhet të plotësojnë korrigjuesit janë si më poshtë:

Korrigjuesit dhe korrigjuesit rishikues duhet të plotësojnë të paktën kërkesat e mëposhtme:

- i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- ii. mbi 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse.
- iii. Njohuri të mira të standardeve profesionale dhe/ose kuadrit rregullator të lidhur me fushën në të cilën do angazhohen si hartues dhe korrigjues dhe të kenë përvojë praktike lidhur me fushën përkatëse;

Kërkesa drejtuar Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale së bashku me dokumentacionin shoqërues do të dorëzohet pranë sekretarisë teknike pranë organizatës profesionale IEKA (një kopje e kërkesës së bashku me dokumentacionin dorëzohet pranë Strukturës Mbështetëse të BMP në rrugë postare ose elektronike).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Dokumentacioni që duhet dorëzuar:

Çdo kandidat që aplikon për hartues, rishikues teze, korigjues dhe rikorigjues duhet të paraqesë zyrtarisht dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarisë teknike të KPAP-së, si dhe një kopje e cila vihet në dispozicion të Strukturës Mbështetëse të BMP-së:

- a. Kërkesë me shkrim për pozicionin që po aplikon;
- b. Curriculum Vitae;
- c. Referencë ose dokument zyrtar për të vërtetuar përvojën në fushën përkatëse për të cilën po aplikon;
- d. Fotokopje të diplomave;
- e. Çertifikatën e gjendjes gjyqësore (informacion për rekorde penale).

**Të gjithë kandidatët do të jenë subjekt i verifikimit për përmbushjen e kërkesave ligjore dhe kuadrit rregullator.*

Shënim*

Afati i dorëzimit të dokumentacionit të kandidatëve për hartues, rishikues teze, korigjues dhe rikorigjues për provimin e aftësive profesionale është deri më **datë 15 Gusht 2024 ora 14:00**.

